

**VENDIM**  
**Nr.639, datë 7.9.2011**

**PËR RIORGANIZIMIN E ZYRËS KOMBËTARE ERASMUS+**

*(Ndryshuar me VKM nr.821, datë 26.11.2014)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Zyra Kombëtare Erasmus+ (ZKE) është person juridik, jobuxhetor, i cili funksionon në përputhje me termat e referencës për funksionimin e Zyrës Kombëtare Erasmus+ (ZKE), të përgatitura nga Komisioni Evropian, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ajo ushtron veprimtarinë nën mbikëqyrjen e ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit, e cila ndjek dhe garanton zbatimin e programit “Erasmus+” në Shqipëri. ZKE-ja ka këto funksione kryesore:

a) Ndhmon ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit dhe Komisionin Evropian në promovimin dhe zbatimin e programit “Erasmus+” në Shqipëri;

b) Përpunon, promovon dhe shpërndan në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë informacionin dhe dokumentacionin e programit “Erasmus+”, të përgatitur nga Agjencia Ekzekutive e Arsimit, Kulturës dhe Veprimtarive Audiovizuale të Bashkimit Evropian (EACEA), organ publik i Komisionit Evropian, si dhe asiston institucionet e arsimit të lartë në aplikimet për projekte “Erasmus+”, duke vënë në dijeni ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit për sa më sipër;

c) Këshillon, informon dhe ndihmon të gjithë kandidatët, institucionet publike të arsimit të lartë, organizatat dhe institucionet e përfshira ose që mund të përfshihen në projektet “Erasmus+” për çështjet për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve që lindin nga kontratat me EACEA-në (Komisioni Evropian);

ç) Kryen mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve “Erasmus+” dhe raporton pranë EACEA-së (Komisionit Evropian) dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit, si dhe jep rekomandimet përkatëse;

d) Ndhmon EACEA-në (Komisionin Evropian) në vlerësimin e projekteve që paraqiten në kuadër të programit “Erasmus+” në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare dhe ia paraqet këtë vlerësim EACEA-së (Komisionit Evropian);

dh) Mbështet dhe bashkërendon aktivitetet e Grupit Kombëtar të Ekspertëve për Reformën e Arsimit të Lartë (Higher Education Reform Experts - HERE), të cilat kanë rol këshillues dhe mbështetës për arritjen e objektivave të programit “Erasmus+”;

e) Mbështet ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit dhe Komisionin Evropian në realizimin e studimeve dhe raporteve për fusha që mbulon programi “Erasmus+”;

ë) Raporton një herë në vit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit lidhur me veprimtarinë e zyrës.

2. Zyra Kombëtare Tempus (ZKT), nëpërmjet programit Tempus, pjesë e “Programit me shumë përfitues në kuadrin e komponentit të IPA-s “Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale””, mbështet reformimin e institucioneve të arsimit të lartë,

ndihmon përafrimin dhe harmonizimin e tyre me zhvillimet brenda BE-së, që rrjedhin nga Agjenda e Lisbonës, procesi i Bolonjës dhe Strategjia Europa 2020.

3. Zyra Kombëtare Tempus (ZKT), në bazë dhe në zbatim të marrëveshjes së financimit, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Komisionit Evropian, për programin me shumë përfitues për Tempus, në kuadër të komponentit të IPA-s “Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale”, ushtron këto funksione”:

a) Asiston KE-në për promovimin dhe rritje e vizibilitetit të programit Tempus;  
b) Përpunon, promovon dhe shpërndan në të gjitha institucionet e arsimit të lartë (IAL), informacionin dhe dokumentacionin e programit Tempus, të përgatitur nga Agjencia Ekzekutive për Arsimin, të drejtat Audiovizuale dhe Kulturën (EACEA), organ publik i Komisionit Evropian;

c) Këshillon, informon dhe ndihmon të gjithë aplikantët dhe IAL-të e përfshira në projektet Tempus për çështje që lidhen me implementimin dhe zbatimin e detyrimeve që lindin nga kontratat me EACEA-në;

ç) Kryen monitorimin e zbatimit të projekteve Tempus dhe raporton pranë EACEA-së për vërejtjet, si dhe jep rekomandimet përkatëse;

d) Kontribuon dhe jep vlerësimin për projektet e paraqitura në kuadër të programit Tempus, në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare dhe ia paraqet këtë vlerësimin EACEA-së;

dh) Nënshkruan kontratën me EACEA-në për implementimin e programit Tempus në nivel kombëtar dhe zbaton detyrimet që rrjedhin prej saj;

e) Mbështet dhe koordinon veprimtaritë e Grupit Kombëtar të Ekspertëve për reformat e arsimit të lartë, HERE (Higher Education Reform Experts), të cilët kanë rol këshillues dhe mbështetës për arritjen e objektivave të programit Tempus;

ë) Administron buxhetin për funksionimin e ZKT-së në Shqipëri, i cili alokohet nga EACEA-ja.

4. Struktura dhe rregullorja e funksionimit të ZKT-së miratohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me termat e referencës së KE-së për zyrat kombëtare Tempus, pas konsultimit me EACEA-në.

5. Zyra Kombëtare Erasmus+ (ZKE) drejtohet nga Koordinatori Kombëtar, i cili është përfaqësuesi ligjor i Zyrës dhe nënshkruan kontratën me Agjencinë Ekzekutive të Arsimit, Kulturës dhe Veprimtarive Audiovizuale të Bashkimit Evropian (EACEA), organ i Komisionit Evropian, si dhe zbaton detyrimet që rrjedhin prej saj.

6. Punonjësit e Zyrës Kombëtare Erasmus+ (ZKE) përzgjidhen nga EACEA (Komisioni Evropian), nëpërmjet procedurave të saj të brendshme.

7. Paga mujore e drejtorit të Zyrës Kombëtare Erasmus+ (ZKE) deri më 31.12.2014 përballohet nga fondet e rialokuara, si kosto lokale nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, zëri “Shpenzime personeli”.

Duke filluar që nga 1 janari 2015 e në vijim, të gjitha shpenzimet financiare për funksionimin e Zyrës Kombëtare Erasmus+ (ZKE), përfshirë kostot për Koordinatorin Kombëtar, stafin, si dhe kostot që lidhen me aktivitetet e ekipit të ekspertëve për reformimin e arsimit të lartë të mbulohen nga fondet e programit “Erasmus+”.

7/1. Zyra Kombëtare Erasmus+ (ZKE) vijon mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve të programit “Tempus IV” deri në përfundimin e tyre.

8. Vendimi nr.485, datë 11.9.1995 i Këshillit të Ministrave “Për funksionet e programit Tempus” i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Zyra Kombëtare Tempus, në Shqipëri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PROGRAMI ERASMUS+**  
**ZYRAT KOMBËTARE ERASMUS+ (ZKE)**  
**TERMAT E REFERENCËS**  
*(Shtuar me VKM nr. 821, datë 26.11.2014)*

**1. Objekti i përgjithshëm i punës**

**Të përgjithshme**

Zyra Kombëtare Erasmus+ (ZKE) ndihmon Komisionin EACEA dhe autoritetet partnere, të vendit të interesuara për zbatimin e programit Erasmus+. ZKE-ja ndjek nga afër zhvillimet e politikës në vendin partner, veçanërisht në fushën e arsimit të lartë por edhe në nivelet e tjera të arsimit, në qoftë se kërkohet.

Përveç delegacionit të BE-së, ZKE-ja është një pikë fokusi në vend për të gjithë aktorët, aplikuesit potencialë, përfituesit dhe aktorët e tjerë në lidhje me veprimtaritë e bashkëpunimit me BE-në në arsimin (e lartë) në kuadrin e programit Erasmus+.

Mandati i Zyrave Kombëtare Erasmus+ në kuadrin e programit Erasmus+ mbulon të gjithë veprimtaritë mbështetëse, promovuese, monitoruese dhe publikuese që lidhen me aktivitetet e Erasmus+ në arsimin e lartë, të hapura për bashkëpunim me vendet partnere (veprimet kyçe 1, 2, dhe 3).

**Zona gjeografike**

ZKE-ja krijohen në disa vende partnere që kanë të drejtën e pjesëmarrjes në veprimet e rritjes së kapacitetit për arsimin e lartë të programit Erasmus+, në veçanti në vendet fqinjë me BE-në, Ballkani Perëndimor, Evropa Lindore dhe Mesdheu Jugor dhe në Azinë Qendrore dhe Federatën Ruse.

**Grupet e synuara**

Aktivitetet e ZKE-së synojnë grupet e mëposhtme të aktorëve:

- Të gjithë përfituesit e Erasmus+ dhe përfituesit potencialë në një vend (të tillë si institucionet e arsimit të lartë, stafi dhe studentët, shoqëria civile, organizatat joqeveritare, sipërmarrjet, shoqatat akademike dhe profesionale, shoqatat e studentëve, organizata profesionale, institucionet e kërkimit, institucionet e trajnimit profesional) dhe ndonjë aktorë tjetër që ka të drejtë për pjesëmarrje në programin Erasmus+ në vendin e tyre. Autoritetet kombëtare, në veçanti ata që përgjigjen për arsimin e lartë dhe organet e tyre të varësisë.

- Aplikuesit potencialë, mbajtësit e grantit, përfituesit dhe aktorët e tjerë në fushën e arsimit të lartë në vendet e programit Erasmus+, aty ku është e mundur.  
ZKE-ja mban kontakte me ZKE të tjera, veçanërisht në të njëjtin rajon dhe me agjencitë kombëtare në vendet e programit Erasmus+ (në veçanti për kërkimin e partnerëve, shkëmbimin e praktikave të mira ose organizimin e eventeve të përbashkëta).  
ZKE-ja, gjithashtu, duhet të mbajë kontakte me personin e kontaktit të veprimit Marie Skłodowska Curie në vendin e tij për të lejuar sinergjitë midis programeve Erasmus+ dhe Horizon 2020.

## 2. Objektivat dhe mandati

### Objektivat e përgjithshme

ZKE kontribuon në objektivat e përgjithshme të mëposhtme: për të përmirësuar sensibilitetin, vizibilitetin, relevancën, efektivitetin dhe impaktin e komponentëve ndërkombëtarë të programit Erasmus+ dhe për të kontribuar në promovimin e tij dhe publikimin e tij në vendin e ZKE.

### Objektivi specifik

- Të asistojë Komisionin, EACEA, Delegacionet e BE-së dhe autoritetet e në vendin partner, për zbatimin e dimensionit ndërkombëtarë të arsimit të lartë të programit Erasmus+.  
- Për vendet partnere, të interesuar, të mbështetë dhe monitorojë zbatimin dhe publikimin e rezultateve të projekteve në vazhdim, të përzgjedhura në kuadrin e programit Tempus IV (2007-2013).

### a) Dimension i arsimit të lartë të programit Erasmus+ përfshin:

#### • Veprimi kyç 1:

- Mobiliteti i Kredisë (hapja ndërkombëtare e Erasmus) i cili do të menaxhohet nga Agjencia Kombëtare në vendet e programit.  
- Mobiliteti i titujve nëpërmjet titujve të përbashkët master (dhe programeve të përbashkëta master dhe të doktoraturës Erasmus Mundus në vazhdim) që menaxhohen nga EACEA.

#### • Veprimi kyç 2:

- Veprimi i rritjes së kapacitetit i cili përfshin një komponent mobiliteti për vendet fqinje dhe Ballkanin Perëndimor.  
- Aleancat e njohurive dhe partneritetet strategjike që janë të hapura ndaj pjesëmarrjes të vendit partner.

#### • Veprimi kyç 3:

- Ekipet e Ekspertëve të Reformës të Arsimit të Lartë  
- Dialogjet e politikës së komisionit me vendet/ rajonet partnere  
- Studimet  
- Kapitujt Rajonal të shoqatave Erasmus + Alumni në vendet partnere  
- Aktivitetet Jean Monnet

- Çdo veprim tjetër i disponueshëm për vendin partner të interesuar.

### b) Rezultatet që do të arrihen nga ZKE

- Sensibiliteti i përmirësuar i Erasmus+ për aplikuesit potencialë dhe aktorët e arsimit të lartë në përgjithësi.  
- Asistenca e cilësisë së lartë për aplikuesit dhe përfituesit.

- Kontributi dhe reagimi në kohë i komisionit dhe kërkesat EACEA në veçanti në lidhje me ushtrimin e konsultimit në kontekstin e procesit të përzgjedhjes.
- Nëpërmjet monitorit të projekteve në vazhdim dhe publikimin e rezultateve (duke përfshirë edhe për programin Tempus IV 2007-2013).
- Vënia në lëvizje dhe mbështetje e Ekipit të Ekspertëve të Ekspertëve të Reformës të Arsimit të Lartë (HERE) në vendin partner.
- Kontributi në jetën e komunitetit të Erasmus+ duke bashkëpunuar nga afër me Komisionin Evropian, Delegacionet dhe Autoritetet Kombëtare.
- Publikimi i informacionit dhe vizibiliteti i vendit partner për iniciativat e tjera të arsimit të lartë të BE-së.

### 3. Aktivitetet specifike

#### a) Aktivitetet dhe informacionet e promovimit

- Të promovojë dhe të publikojë të gjithë informacionin në lidhje me këto veprime dhe aktivitetet e hapura për pjesëmarrjen e vendit të ZKE brenda programit Erasmus+: sfondi, objektivat, procedurat e aplikimit dhe kalendarë, rregullat e përzgjedhjes, procesi i përzgjedhjes, provigjonet financiare, udhëzimet për përdorimin e grantit, praktikat më të mira, kontaktet përkatëse dhe faqet e internetit etj.
- Të organizojë konferenca, seminare, ditë informacioni dhe veprime të tjera dhe evente për të promovuar programin Erasmus+ dhe për të shfrytëzuar rezultatet e tij. Të hartojë raporte, dhe aty ku duhet deklarata shtypi, kur organizohen dhe merr pjesë në evente, konferenca, seminare etj.
- Të respektojë dhe të publikojë udhëzimet e duhura të vizibilitetit në lidhje me njohjen e financimit nga BE të projekteve dhe aktiviteteteve të Erasmus+.
- Të mbështet Komisionin dhe EACEA për organizimin e eventeve të Erasmus + në vendet partnere.

#### b) Asistenca për aplikuesit potencialë dhe përfituesit

- Të këshillojë, informojë dhe asistojë aplikuesit potencialë.
- Të organizojë mbledhje informacioni /kontakti, seminare për aplikuesit potencialë.
- Në bashkëpunim të ngushtë me ZKE të tjera dhe/ose agjencitë kombëtare Erasmus+ në vendet e programit, të asistojë organizatat vendore në kërkim të partnerëve kombëtarë ose të huaj, si dhe organizatat e huaja në kërkim të partnerëve vendor.
- Të asistojë organizatat (të arsimit të lartë dhe tipave të tjerë të institucioneve), si dhe individë (studentë, staf të universitetit, profesionistë etj.) të përfshirë në aktivitetet e Erasmus + (në lidhje me vizat, tatimet, siguracionin, importimin e pajisjeve, kontaktet me autoritetet vendore dhe delegacionin e BE-së etj.).
- Të promovojë bashkëpunimin, të rritë sinergjitë dhe të mbështetë shkëmbimin e praktikave të mira/më të mira midis projekteve të Erasmus + aktive në vendin partnerë.

#### c) Përzgjedhja, monitorimi dhe publikimi i Erasmus+ dhe të ish-Tempus IV duke përfshirë vizitat në terren

- Aty ku duhet dhe ku kërkohet (përkatësisht për Veprimin Kyç 2 Rritja e Kapacitetit në Arsimin e lartë të programit Erasmus +), të kontribuojë për proceset e përzgjedhjes dhe të bëjë komente për aplikimet e projektit në shërbimet e BE-së kur konsultohet në kuadrin e proceseve të përzgjedhjes.
- Të monitorojë zbatimin e Erasmus+ dhe projekteve në vazhdim të Tempus IV në vendin partnerë dhe të kontribuojë në publikimin e rezultateve të tyre.

- Të organizojë dhe kryejë vizita monitoruese në terren të Erasmus+ dhe të projekteve në vazhdim të Tempus IV në të gjithë vendin.
  - Të asistojë Komisionin, EACEA dhe çdo organ tjetër të jashtëm të autorizuar për ta bërë këtë në emrin e tyre në vizitat e tyre monitoruese/audituese në terren.
  - Të përgatitë dhe të depozitojë raporte të monitorimit në terren tek EACEA, duke përfshirë rekomandimet për ndjekjen e projekteve.
  - Të kontribuojë në përcaktimin nga EACEA të planeve/kalendarëve të monitorimit në terren për komponentë të ndryshëm të programit Erasmus+ atje ku duhet.
  - Të përmbledhë konstatimet e fushatës vjetore të monitorimit në terren për çdo komponent përkatës të programit Erasmus+ dhe ta depozitojë raportin tek EACEA.
- d) Mbështetja për ekipin e Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE)
- Në lidhje me HERE, të ndjekë zhvillimet e politikës në fushën e arsimit të lartë ne venin partnerë dhe më tej.
  - Të mbështetë dhe të koordinojë aktivitetet vendore të ekipit të Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë. Të sigurojë ndjekjen eficiente vendore dhe publikimin e aktiviteteve të tyre, që mbahen jashtë vendit partnere.
  - Të asistojë në procesin e përzgjedhjes, të emërimit, rinovimit të Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë në vendin partner.
  - Të krijojë programin vjetor të punës, të zbatojë buxhetin dhe të monitorojë aktivitetet e HERE. Në veçanti, ZKE-ja menaxhon pjesën e shpenzimeve që kryhen nga pjesëmarrja e HERE në eventet e jashtme (kostot e udhëtimit, dietat ditore,) dhe kostot që lidhen me iniciativat vendore që përfshijnë HERE.
  - Të përgatitë raportet për aktivitetet që zbatojnë ekipi i HERE për EACEA dhe shërbimet e Komisionit.
  - Të mbajë të informuar autoritetet vendore për programet e punës, si dhe për aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara.
- e) Aktivitete të tjera që lidhen me arsimin e lartë
- Të marrë pjesë në mbledhjet e koordinimit të ZKE-së me kërkesë të EACEA (zakonisht në Bruksel dy here në vit).
  - Të marrë pjesë nëse është e nevojshme në trajnimin specifik, konferencat, seminarët që lidhen me programin e Erasmus+ për të përmirësuar njohuritë e stafit të ZKE-së dhe të rritë sensibilitetin mes institucioneve dhe aktorëve që përfshihen në program.
  - Të publikojë çdo informacion përkatës në lidhje me thirrjen për propozime të lançuara në kontekstin e programeve të BE-së dhe iniciativave në arsimin e lartë që janë relevante për organizatat dhe/ose shtetasit nga vendi i programit.
- Të asistojë Komisionin, EACEA ose ndonjë organ tjetër të jashtëm të autorizuar për ta bërë këtë në emër të tij në vizitat në vende në kuadrin e realizimit të studimeve, identifikimin e projektit ose formulimin, vlerësimet afat mesme ose përfundimtare, ose misione të tjera.
  - Të mbajë lidhje me autoritetet vendore në bashkëpunim me delegacionin e BE-së.
  - T'i japë Komisionit dhe EACEA kontribute për studimet, raportet analitike/statistikore etj. që lidhen me arsimin e lartë (dhe mundësisht në nivele të tjera të arsimit nëse duhet).
  - T'i japë Komisionit dhe EACEA mbështetjen për përgatitjen, organizimin dhe pritjen e mbledhjeve dhe eventeve.

- T'u japë mbështetje aktiviteteve të dialogut të politikës në fushën e arsimit të lartë lançar nga Shërbimet e Komisionit.
- T'i japë delegacionit të BE-së informacion për performancën e projekteve të Erasmus+ në arsimin e lartë që përfshinë organizatat nga vendi partnerë dhe të japë informacion të përditësuar për sektorin e arsimit të lartë në veçanti.
- Të japë mbështetje për përkthimin e dokumenteve që lidhen me programin e Erasmus+.
- Detyra të tjera që kërkon EACEA ose Komisioni.
- Iniciativat ose veprimet shpesh u nënshtrohen miratimit paraprak nga EACEA ose nga Komisioni.

#### 4. Struktura e ZKE-së

ZKE-ja duhet të krijohet e pavarur si një person ligjor autonom.

Llojet e tjera të strukturës së personit ligjor mund të pranohen si derogim me kushtin që të lejojë:

- a) funksionim optimal dhe të qëndrueshëm të zyrës, që i mundëson stafit të saj të kapitalizojë përvojën, të zhvillojë dhe të mirëmbajë një nivel të lartë profesionalizmi;
- b) autonomi të veprimeve për ndonjë menaxhim dhe çështje financiare përballë autoriteteve dhe aktorëve të tjerë vendorë;
- c) mjedis të sigurt nga ana ligjore, kontraktuale dhe financiare për stafin e saj;
- d) mjedis të sigurt nga ana ligjore, kontraktuale dhe financiare me EACEA dhe Komisionin në zbatimin e rregulloreve të Komisionit.

Anëtarët e stafit të ZKE-së janë profesionistë në fushën e tyre dhe angazhojnë që të respektojnë kodin e sjelljes të ZKE-së. Detyrat me kohë të pjesshme janë të kufizuara dhe parapëlqimi i qartë është për pozicionet me kohë të plotë. Anëtarët e stafit deklarojnë ndonjë aktivitet tjetër në rast se ata përfaqësojnë më shumë se 25% të detyrave të tyre normale /shpërblimeve në ZKE.

Anëtarët e stafit nuk janë të autorizuar të kryejnë në kuadrin e detyrave të tyre normale në ZKE, aktivitete që nuk lidhen me Erasmus+.